## 1. Kontakti

Në këtë pjesë të panelit ju mund të shkruani një pyetje, një ankesë ose të jepni një këshillë.






## 2. Ndihmë

Në këtë faqe mund të merrni informacion rreth produktit për të cilin jeni i interesuar.




## 3. Vecoritë e gjuhës

Ju mund të zgjidhni dy gjuhë nga menuja, Shqip ose Anglisht. Në fund të faqes në të djathtë të saj gjeni opsionin për të ndryshuar gjuhën.



## 4. Dalje

Duke klikuar **Dalje** ju do të dilni nga sistemi. Për tu aksesuar sërisht në Degën Internet të Biznesit logohuni direkt nga faqja zyrtare e BKT.




## 5. Pyetje dhe përgjigje

### 5.1 Logimi

**Cilat janë kërkesat për tu regjistruar në BKT Business E-Banking?**

Të gjithë klientët e BKT që kanë një kartë debiti/krediti individuale/biznesi dhe kanë firmosur marrëveshjen e KSHBB-së dhe dokumentacionin për aktivizim të shërbimit në Internet(marrëveshjen xxx) mund të regjistrohen në BKT Business E-Banking.

**Cfarë është Numri i klientit?**

Numri i klientit është një numër i cili ju jepet kur hapni një llogari në BKT. Numri i klientit përdoret në hapin e parë të proçesit të hyrjes. Këtu përdoret nr i klientit dhe nr identifikues i kompanisë (NIPT ).

**Cfarë është një fjalëkalim?**

Një fjalëkalim është një kombinim i karaktereve alfanumerike që ju duhet të krijoni gjatë proçesit të regjistrimit për sigurinë tuaj.

**Cfarë është FNP?**

FNP (Fjalëkalim Një Përdorim) është një hap sigurie në proçesin e hyrjes në BKT Business E-Banking. Kërkohet të vendoset Fjalëkalimi që ju dërgohet në celularin tuaj nëpërmjet mesazhit kur hyni.

**Cfarë është një tastierë virtuale?**

Tastiera virtuale është një aplikim opsional që ju mund të përdorni për të mënjanuar rrezikun e ndonjë ndërhyrje nga tastiera manuale.

**Cfarë duhet të bëj nëse harroj Numri i klientit dhe fjalëkalimin tim?**

Duhet të kontaktoni me BKT Call Center në numrin e telefonit (0)4 22 66 288.

**Cfarë duhet të bëj nëse bllokoj llogarinë time të Internet Banking?**

Duhet të kontaktoni me BKT Call Center në numrin e telefonit (0)4 22 66 288.

**Cfarë duhet të bëj nëse nuk marr ndonjë mesazh FNP?**
Ju lutem kontrolloni nëse jeni brenda zonës së mbulimit të rrjetit tuaj GSM ose kontrolloni inbox-in e mesazheve nëse është plot. FNP mund te mos dërgohet në celularin tuaj dhe si pasojë e arsyeve mëposhtë:

1. Gabim ne sistemin online bankar;
2. Ju nuk keni të përditësuar numrin e saktë të celularit në të dhënat tuaja bankare;
3. Vjedhje e të dhënave të llogarisë së klientit/modifikim i paautorizuar i numrit të kontaktit ndërkohë që ju vijoni të zotëroni të njëjtin numer telefoni;

**Nëse ju verifikoni se dështimi nuk ka ardhur si pasojë e faktorit 1 dhe 2 ju lutem të kontaktoni menjëherë BKT Call Center klienti në numrin e telefonit (0)4 22 66 288.** Në të kundërt duhet të kontrolloni dhe të ripërtërini regjistrimin e nr tuaj në një prej degëve te BKT-së.

## 5.2 Siguria

**A mund ta ndryshoj fjalëkalimin tim?**
Po. Ju mund të ndryshoni fjalëkalimin tuaj tek menu-ja e Mbi Sigurinë tek Internet Banking.

**Pse duhet ta ndryshoj fjalëkalimin?**
Për arsye sigurie, do t'ju kërkohet të ndryshoni fjalëkalimin tuaj cdo 90 ditë. Sigurohuni që ju të ndryshoni fjalëkalimin tuaj rregullisht. Nëse ju nuk e keni ndryshuar fjalëkalimin tuaj. Banka do t'ju kërkojë ta ndryshoni atë në mënyrë periodike.

**Cfarë duhet të bëj nëse humbas celularin?**
Duhet të mbyllni kartën tuaj SIM sa më shpejt të jetë e mundur për të evituar ndonjë rrezik referuar fazës së FNP në proçesin e logimit.

**Cfarë duhet të bëj nëse marr një mesazh FNP nga BKT edhe pse nuk jam përpjekur të hy në internet banking?**
Ju lutem përpiquni të ndryshoni fjalëkalimin tuaj nëse është e mundur dhe/ose kontaktoni me BKT Call Center në mënyrë që të merren veprime të tjera për sigurinë e llogarisë suaj.

**Cilat janë ndihmat për sigurinë e Internet Banking?**
Ju duhet të përcaktoni fjalëkalim të fortë i cili të përmbaje karaktere alfanumerike, duhet të jetë nga 6 deri në 16 karaktere, ne ju kujtojmë të mos përcaktoni një që përmban detajet tuaja personale. Ju nuk duhet të ndani detajet tuaja të logimit me të tjerë ose ti mbani atje ku janë të aksesueshme nga të gjithë.

**A mund ta aksesoj BKT Internet Banking nga jashtë Shqipërisë?**
Po. Ju mund ta aksesoni BKT Internet Banking nga jashtë Shqipërisë. Nuk ka nevojë për kërkesa shtesë.

**Me cfarë browser-i mund të logohem në BKT Internet Banking?**
Ju mund ta aksesoni BKT Internet Banking me Internet Explorer, Mozilla Firefox, Opera, Safari dhe Google Chrome. Kërkohet të përdoret të paktën versioni 5.0 për Internet Explorer për një performancë më të mirë.

## 5.3 Përdorimi

**Kur mund ta përdor BKT Internet Banking?**
Ju mund të përdorni Internet Banking për 24 orë.

**Kur mund të bëj veprime financiare në BKT Internet Banking?**
Ju mund të kryeni Transferta Brenda Vendit deri në 14.00. Nuk ka limit për pjesën tjetër të transaksioneve financiare si Këmbim Valutor dhe Pagesë Karte. (Përjashtime: ju nuk mund të bëni transaksione financiare gjatë procesit ditor të përditësimit që fillon në orën 21.00 dhe zgjat deri në mesnatë)

**Kur ekzekutohen transaksionet e BKT Internet Banking?**
Transaksionet tuaja ekzekutohen online. Ju mund t'i  kontrolloni ato online duke vizituar menunë e Veprimet e llogarisë.

**Cfarë duhet të bëj nëse nuk mund të kryej një transaksion financiar?**
Ju do të informoheni më një mesazh gabimi specifik për arsyen. Nëse shihni një mesazh gabimi të përgjithshëm ju lutem kontaktoni me BKT Call Center për detaje.

**A ka një menu Ndihme?**
Po. Ka një menu ndihmë në krye të faqes e cila ju jep detaje për menunë që po përpiqeni të përdorni.

**Cfarë duhet të bëj nëse kam ndonjë ankesë ose sugjerim për BKT Internet Banking?**
Ju mund të klikoni Kontaktet e cila është e vendosur në krye të faqes për të lënë një mesazh ose mund të kontaktoni BKT Call Center ose degët.